

Të Krishterët për Izraelin Kalendari i lutjes për Izraelin



Shalom,

“Në qoftë se Zoti nuk ndërton shtëpinë, më kot lodhen ndërtuesit; në qoftë se Zoti nuk ruan qytetin, më kot e ruajnë rojet.” Psalmet 127:1

Në dy muajt e ardhshëm ne do të jemi duke u lutur për Izraelin dhe kujdesin e domosdoshëm të Perëndisë për atë tokë. Në qoftë se Zoti nuk ruan, ne si roje qëndrojmë në ruajtje më kot. Izraeli është i kërcënuar nga të gjitha anët, dhe ruajtja e Zotit mbi Izraelin është e domosdoshme. Izraeli është aktualisht në një kohë pasigurie politike. Izraeli do të mbajë zgjedhje elektorale në Mars për të zgjedhur një parlament të ri. Është e rëndësishme që atje të jetë një qeveri e mirë që mund ta qeverisë Izraelin me efektivitet, por është edhe më e rëndësishme që qeveria të besojë tek Perëndia dhe të besojë se Perëndia e ruan Izraelin dhe e ndërton atë.

Në këtë kalendar lutjeje ne do të flasim për personazhe biblike sërish të shtunave, njerëz të cilët janë shembuj për ne se si të lutemi. Personi më i rëndësishëm është Jezusi. Është një inkurajim i pabesueshëm të dimë se jo vetëm lutemi siç u lut Jezusi, por që Jezusi gjithashtu lutet për ne.

“Unë lutem për ta, nuk lutem për botën, po për ata që më ke dhënë, sepse janë të tutë. Dhe të gjitha gjërat e mia janë të tuat, dhe gjërat e tua janë të miat dhe unë jam përlëvdur në to.” Gjoni 17:9-10

Ekipi i Kalendarit të Lutjes

Shkurt 2020

E shtunë 01/02, Shabat. **Ezdra**. Si një prift dhe mësues i ligjit, ai i mësoi njerëzit pasi u kthyen nga mërgimi. Ai gjithashtu i bëri ata të kthehen tek statutet e Perëndisë së tyre. Falënderoni për faktin që edhe sot hebrenjtë kthehen në Izrael nga kombe të tjera dhe zbulojnë se kush është Perëndia me anë të fjalës profetike. Rabi Kook tha: “Populli i Izraelit përket në tokën e Izraelit për të përlëvdur emrin e Perëndisë atje.”

E diel 02/02 “Atij që bën gjëra të mëdha dhe që nuk mund të njihen, mrekulli të panumërta. Që i jep shiun tokës dhe dërgon ujin në fusha.” Jobi 5:9-10. Falënderoni për gjithë shiun që ka rënë tashmë këtë dimër në Izrael. Ishte goxha thatësirë në vjeshtë, por tani është kompensuar shumica.

E hënë 03/02 Organizata terroriste libaneze, Hesbollah, përdor një qendër në Berlin dhe 20 vendndodhje të tjera (duke përfshirë xhami) në Gjermani për të rekrutuar anëtarë dhe për të ngritur fonde për terrorizëm dhe blerje armësh. Lutuni që kjo të ndalohet. Dhe lutuni që Hesbollahu të mos e dëmtojë Izraelin në asnjë mënyrë.

E martë 04/02 Ka aktualisht 57,000 veteranë me aftësi të kufizuara dhe mbi 500 prej tyre janë dëmtuar rëndë. Rreth 5,000 veteranë vuajnë nga sindroma e stresit post-traumatik. Lutuni për forcë dhe ngushëllim për gjithë këta veteranë. Dhe lutuni për paqen e Izraelit që të mos ketë më shumë viktime.

E mërkurë 05/02 Raketa dërgohen drejt Izraelit nga Gaz, por edhe nga Siria. Fatmirësisht, këto raketa nga Siria së fundi janë kapur nga sistemi mbrojtës kundërajror izraelit, Kubeja e Hekurt. Lutuni që Perëndia të mbrojë Izraelin kundër raketave nga Gaza dhe nga Siria.

E premte 06/02 Çereku i popullsisë izraelite aktualisht jeton në varfëri, duke përfshirë 1 milion fëmijë. Lutuni që qeveria të marrë më shumë veprime kundër varfërisë. Gjithashtu lutuni për bekime në punën e organizatave si Hineni, që kanë kuzhina për supë me qëllim sigurimin e vakteve për njerëzit në nevojë.

E shtunë 08/02 Shabat. **Nehemia**. Kur Nehemia merr një lajm rreth gjendjes së shkretët të qytetit të Jerusalemit, ne lexojmë në kapitullin 1:45 “Pastaj mbajta zi disa ditë me radhë, agjërova dhe u luta përpara Perëndisë së qiellit.” Në kapitullin 2:4 ne gjithashtu lexojmë se Nehemia u përgjigjet rrethanave me lutje. Le të përgjigjemi dhe ne me lutje ndaj asaj që ndodh në Izrael si shtet dhe si popull.

E diel 09/02 “Dhe mos harroni të bëni bamirësi dhe t’u jepni ndihmë të tjerëve, sepse Perëndisë i pëlqejnë flijime të tilla.” Hebrejve 13:16. Lutuni për të mbijetuarit e Holokaustit në Izrael. Këta njerëz zakonisht jetojnë në varfëri dhe vetmi. Fatmirësisht, gjithashtu ka shumë organizata që ofrojnë ndihmë. Lutuni për bekime në punën e këtyre organizatave.

E hënë 10/02 *Tu Bishvat: Viti i Ri për Pemët*. Sot hebrenjtë festojnë Tu Bishvat. Origjinalisht kjo është një festë e rëndësishme në lidhje me ligjet e të korrave dhe të dhjetës në tempull. Falënderoni Zotin për bekimin e tokës së Izraelit dhe mundësisë për të mbjellë shumë lloje frutash dhe perimesh në tokë.

E martë 11/02 Sistemi i ri i alarmit i ushtrisë izraelite parandalon që zonat ku nuk ka rrezik direkt, të mos alarmohen nga sirenat. Kjo do të thotë se dëgohen 50% më pak sirena. Falënderoni për këtë zhvillim, i cili bën që izraelitët të mos tremben në mënyrë të panevojshme.

E mërkurë 12/02 Universiteti i Tel Avivit ka hapur një degë për shkencën kuantike. Shkenca kuantike është një degë me rëndësi në rritje. Falënderoni për faktin që Izraeli mund të bëjë një kontribut të rëndësishëm në këtë kërkim dhe shumë të tjera, si për shembull në fushën e shkencës mjekësore, dhe kështu mund të jetë një bekim në botë.

E enjte 13/02 Vjeshtën e kaluar, një tjetër sulm raketash ishte hedhur nga Gaza në Izrael. Gjithsesi, asnjë izraelit nuk është vrarë nga kjo. Falënderoni Zotin për mbrojtjen e Izraelit.

E premte 14/02 Lutuni për urtësi për ushtrinë dhe qeverinë izraelite në mënyrën e trajtimit të terrorizmit nga Gaza. Lutuni që konflikti të mos përshkallëzohet.

E shtunë 15/02 Shabat. **Jobi**. Pas një kohe shumë të mundimshme, Jobi gjen paqe në lutje (Jobi 42). Bisedat ndërmjet Jobit dhe miqve të tij duken pak si dy biseda ndërmjet dy hebrenjve. I pari thotë: “Holokausti ka hequr besimin tim në Perëndinë.” Të cilit i dyti i përgjigjet: “Holokausti ishte momenti që më bëri të ruaja besimin në Perëndinë.” Kjo do t’ju lërë pa fjalë. Perëndia është gjithmonë aty, në vuajtje dhe në pendim.

E diel 16/02 “Sepse ai do të urdhërojë engjëjt e tij të të ruajnë në të gjitha rrugët e tua.” Psalmi 91:11. Lutuni për të gjithë qytetet afër Gazës. Ata kanë qenë duke jetuar në rrezik të madh për vite. Lutuni për njerëzit e atyre qyteteve të gjejnë një mënyrë për t’u marrë më tensionin dhe që ata të ndiejnë ushtritë mbrojtëse të engjëjve të Perëndisë.

E hënë 17/02 Lutuni për ata që përjetojnë dëm material, fizik, mendor dhe emocional nga sulmet e vazhdueshme me raketa. Lutuni për shërim për gjithë këtë.

E martë 18/02 Gjatë një ceremonie betimi, ushtarët e forcës mbrojtëse izraelite marrin jo vetëm një armë po dhe Tanakh-un, Dhiatën e Vjetër. Lutuni që ushtarët ta lexojnë atë dhe si rezultat edhe ushtarët jobesimtarë të kthehen në besim.

E mërkurë 19/02 40% e izraelitëve që jetojnë në periferi të Izraelit në veri ose në jug nuk ndihen të sigurt sipas kërkimeve të qeverisë. Rreth 30% e popullsisë nuk ka streha bombash afër shtëpive të tyre. Lutuni që të bëhen ndryshime në shtëpi që ata të ndihen më të sigurt. Gjithashtu lutuni për mbrojtje dhe forcë për të gjithë ata që nuk ndihen të sigurt.

E enjte 20/02 Hamasi së fundmi ka kërcënuar që nëse Izraeli e vazhdon bllokadën në Rripin e Gazës, ata do të përballen me 70,000 luftëtarë nga Hamasi. Lutuni që ky të jetë një kërcënim bosh dhe që Hamasi mos të ketë mundësi t'i shkaktojë dëme Izraelit.

E premte 21/02 Me anë të Shin Bet-it (shërbimit sekret izraelit), rreth 450 sulme terrori janë ndaluar vitin e kaluar. Mund të jemi shumë falënderues për këtë fakt, por në të njëjtën kohë duhet të vazhdojmë të lutemi që kjo organizatë, me teknologji të avancuar dhe njerëz shumë kompetentë, do të vazhdojë të ketë një avantazh ndaj armiqve të tyre.

E shtunë 22/02 Shabat. **Jeremia**. Pas një fjale nga Zoti, Jeremia bleu një fushë në Anathoth dhe vulosi të drejtën e shpengimit (Jeremia 32). Pas kësaj ai iu lut Zotit (vargu 16). Kështu duhet të jetë edhe lutja jonë për Izraelin; duke ruajtur, dëgjuar dhe duke vepruar siç duhet. Nëse ka rrethana të vështira në Izrael, lutjet tona kanë shumë vlerë. Njësoj si miqësia dhe dashamirësia jonë.

E diel 23/02 "I fshiva shkeljet e tua si një re e dendur, dhe mëkatet e tua si një mjegullinë; kthehu tek unë, sepse unë të kam çliruar." Isaia 44:22. Lutuni për izraelitët jobesimtarë. Shumë prej tyre akoma marrin pjesë në festime hebraike, por thonë që nuk besojnë më në Perëndinë. Lutuni për këta izraelitë jobesimtarë që të kthehen në besim.

E hënë 24/02 Arabët izraelitë kohët e fundit dolën në rrugë me demonstrata për më shumë polici izraelite në lagjet e tyre. Lutuni që qeveria izraelite do të bëjë vendimin e duhur për këtë çështje dhe që krimi të vijë duke u ulur.

E martë 25/02 Së fundmi një delegacion gazetarësh nga shtetet arabe me të cilat Izraeli nuk ka lidhje, udhëtuan përmes tokës së Izraelit. Qëllimi i udhëtimit ishte që t'u tregonte atyre se si është me të vërtetë në Izrael. Falënderoni për këtë vizitë të veçantë dhe lutuni për më shumë krahëhapje nga shtetet arabe ndaj Izraelit.

E mërkurë 26/02 Lutuni për mbrojtjen e fshatrave izraelite në Jude-Samari. Terroristët janë duke ardhur rreth kësaj zone duke pritur për një mundësi për të sulmuar një izraelit hebre. Lutuni që këto sulme të parandalohen.

E enjte 27/02 Lutuni për ushtrinë izraelite. Lutuni për drejtuesit e ushtrisë për t'u përgjigjur në mënyrë adekuate ndaj kërcënimeve dhe sulmeve, dhe që Perëndia të qëndrojë besnik ndaj njerëzve që po mbrojnë atë shtet.

E premte 28/02 Të hënën tjetër, Izraeli do të organizojë zgjedhjet elektorale të treta në hapësirën kohore të një viti për të zgjedhur një parlament të ri. Lutuni që përgatitjet për zgjedhje të shkojnë mirë, dhe që njerëzit të jenë të informuar mirë rreth ideve në të cilat qëndrojnë partitë.

E shtunë 29/02 Shabat. **Danieli.** Pavarësisht ligjit që deklaronte se mbreti Dar ishte superior ndaj çdo perëndie, dhe që të gjithë nënshtetasit e mbretërisë së tij të fuqishme duhet ta adhuronin atë, Danieli i qëndroi besnik Perëndisë dhe u lut 3 herë në ditë drejtuar nga Jerusalemi. (Danieli 6:11). Një mësim tjetër për ne është t'i qëndrojmë besnikë Perëndisë në lutje, nën çdo rrethanë.